



Lajmet

22/12/2022

Elbasan – Vihen Në Pranga 3 Shtetas Dhe Procedohen Në Gjendje Të Lirë 3 Të Tjerë

Elbasan/Vihen në pranga 3 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 3 të tjerë, për vepra të ndryshme penale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Elbasan arrestuan në flagrancë shtetasin J. B., 41 vjeç, banues në Elbasan, pasi ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj ish-bashkëshortes së tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve ndaj Personit dhe Pasurisë të DVP Elbasan referuan materialet në Prokurori dhe nisi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasin Sh. N., 70 vjeç, banues në Elbasan, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar një sasi të konsiderueshme lëndësh kimike të rrezikshme për shëndetin, pa dokumentacionin përkatës.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Librazhd arrestuan në flagrancë shtetasin E. L., 41 vjeç, banues në Prrenjas, për veprën penale “Dhuna në familje”, pasi ka ushtruar dhunë ndaj nënës së tij.

Po nga këta specialistë u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit E. D., 18 vjeç, banues në Librazhd, për veprën penale “Vjedhja”, pasi u kap duke vjedhur një sasi naftë, në një mjet tip ekskavator në pronësi të firmës kontraktore për ndërtimin e rrugës, në fshatin Dorëz.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Peqin referuan materialet në Prokurori dhe nisi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasin P. E., 46 vjeç, banues në Peqin, pasi i ka marrë me vetëgjyqësi shtetasit G. Gj., një automjet të marrë me qira te shoku i tij. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit P. E., u gjet dhe u sekuestrua një armë gjahu, që ky shtetas e mbante pa leje. Në vijim të veprimeve për këtë rast nisi procedimi penal në gjendje të lirë edhe për shtetasin G. Gj., 28 vjeç, banues në Elbasan, pasi gjatë kontrollit në automjet, iu gjet një fenelinë si ato që përdor Policia.

Elbasan/Informacion paraprak

Më datë 22.12.2022, në aksin rrugor Elbasan-Peqin, në fshatin Paper, është gjetur i pajetë, në rrugë, një shtetas ende i paidentifikuar.

Nga veprimet hetimore paraprake dyshohet se ky shtetas ka humbur jetën pasi është aksidentuar nga një drejtues automjeti, ende i paidentifikuar, i cili është larguar nga vendngjarja.

Grupi hetimor po punon për zbardhjen e rrethanave të aksidentit, identifikimin e viktimës, identifikimin dhe kapjen e drejtuesit të automjetit.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ DVP Korçë – Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 3 të tjerë

Berat – Theu masën e sigurisë “Arrest në shtëpi”, arrestohet në flagrancë 35-vjeçari ▶